



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:210563

Datë: 28.09.2020

Numri i dokumentit: 01142562

P.nr.102/2020

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për krime të rënda, gjyqtari njëherit edhe kryetari i trupit gjykues Xheladin Osmani, me sekretaren juridike Teuta Spahija, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit N.T, nga Fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRS-ës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr./IInr.1945-14/19, e dt.01.10.2019, pas mbajtjes së seancës fillestare me datën 25.09.2020, në praninë e prokurorit të shtetit Genc Nixha, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. V.H, po të njëjtën ditë publikisht muar dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

I akuzuari N.T, nga i ati I. e ëma Z., me mbiemër të vajzërisë G., i lindur me datë ..., në Prizren, me banim në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, bukëpjekës, i martuar, babai i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendje së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 20.08.2019, rreth orës 23:00, në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, mban në pronësi armen dhe atë një pistoletë të modelit "Gold Custom Eric 2010" me kaliber 9 mm, me nr. serik: ..., ngjyrë hiri së bashku me një shanzher (karrikator) të pistoletës, që të gjitha këto pa leje të organit kompetent si dhe në kundërshtim me lejen për armën nr. ..., të lëshuar me datë 14.03.2019, e cila përcakton saktë se arma në fjalë mund të mbahet, përkatësisht të përdoret vetëm për qëllime shenjëtarie gjë që me veprimet e tij bie në kundërshtim me ligjin nr. 05/L-022 për armën.

-Kësodore kryen veprën penale, mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 3, par.1,7,8,9,10,40,43,69,70,71,72 të akuzuarin N.T

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqindë) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke u ndërlidhur me nenin 43 par.3 të KP, dhe se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundë të paguaj dënimin me gjobë, gjykata mundë të ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 Euro të dënimit me gjobë do ti caktoj një(1) ditë burgu, ose në tersi prej 79 ditë burgim.

Gjykata, në bazë të nenit 366 par. 3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit N.T, i shqipton dënim plotësues;

MARRJEN E SENDIT

Ashtu që prej të akuzuarit merret pistoleta me ngjyrë të zezë, modeli "Gold Custom Eric 2010" me kaliber 9 mm, me nr. serik: ..., ngjyrë hiri së bashku me një shanzher (karrikator) të pistoletës.

Obligohet i akuzuari të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 Euro, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e formës së prerë të aktgjykimit.

Në bazë të qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-36, për kompensimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018, obligohen të pandehurit që konform nenit 39 të Ligjit të lartëcekur të paguajnë shumën prej 50 € (pesëdhjetë) në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë, PP/II nr. 1945-14/19 të dt.01.10.2019, kundër të akuzuarit N.T, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK.

Aktakuza në fjalë gjatë seancës fillestare e ka përfaqësuesi Prokurori i shtetit Genc Nixha i cili propozojë që seanca fillestare të mbahej dhe të veprohet konformë dispozitave të KP, nga se aktakuza është bazuar me provat e pranueshme.

Në seancën fillestare, i akuzuari u udhëzua në kuptim të nenit 246 të KPP për të drejtat e tij dhe pasi që të drejtat e tija janë respektuar, pas leximit të aktakuzës, i akuzuari ka kuptuar aktakuzën i është ofruar mundësia e tij të pranojnë fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës.

Kryetari i trupit gjykues vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, nga materialet e prezentuara nga prokurori i

shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çart ligjore ose gabime faktike, i akuzuari e pranoi fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe atë pas marrjes së mendimit të prokurorit, dhe vet të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij, mori vendimin mbi pranimin e fajësisë e pastaj është vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me vet pranimin nga ana e të akuzuarit N.T dhe nga shkresat e lëndës, është vërtetuar në tërësi se i akuzuari me datë 20.08.2019, rreth orës 23:00, në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, mban në pronësi armen dhe atë një pistoletë të modelit "Gold Custom Eric 2010" me kaliber 9 mm, me nr. serik: ..., ngjyrë hiri së bashku me një shanzher (karrikator) të pistoletës, që të gjitha këto pa leje të organit kompetent si dhe në kundërshtim me lejen për armën nr. ..., të lëshuar me datë 14.03.2019, e cila përcakton saktë se arma në fjalë mund të mbahet, përkatësisht të përdoret vetëm për qëllime shenjëtarie gjë që me veprimet e tij bie në kundërshtim me ligjin nr. 05/L-022 për armën.

Gjykata, gjatë shqiptimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në zgjedhjen e llojit të lartësisë së dënimit, duke e gjetur si rrethanë rënduese rrezikun shoqëror, shkallën e rrezikut të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, pranimin e fajësisë, është baba i ... fëmijëve dhe mbajtës i vetëm i familjes dhe gjerë më tani i padënuar, për këtë gjykata ia shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bindur se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit është marrë në kuptim të nenit 366 par.3 TË KPRK.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2.6të KPP-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjit nr.05/L-36, për kompensimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018,

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
PKR.nr.102/20 me date: 25.09.2020

Sekretarja juridike,
Teuta Spahija

Kryetari i trupit gjykues,
Xheladin Osmani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën së Apelit në Prishtinë.